



Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur në takimin e Ekzekutivit të Komunës me qytetarë të Sfeçlës dhe fshatrave përreth, mbajtur më 08 gusht 2019

Takimi filloi në orën 14:05, dhe u mbajt në SHFMU “Ali Ajeti” në fshatin Sfeçël.

Takimin e hapi dhe kryesoi z.Isuf Latifi, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin edhe, Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Faik Muçiqi drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Abaz llugaliu, drejtor i drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, dhe Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit.

Pjesëmarrësit tjerë në këtë takim janë të evidentuar dhe nënshkruar në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë e këtij procesverbali.

Tema: Dëgjim buxhetor rreth përgatitjes së propozim Buxhetit të Komunës për vitin 2020 dhe prioritetet për vitet 2021/2022

Isuf Latifi, drejtor i DBF, e hapi takimin duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje që e vlerësoj mjaft të rëndësishëm për lokalitetet e kësaj rrethine, ndër të tjera theksoi.

Jeni në dijeni se për çdo vit, gjatë këtyre muajve Komuna zhvillon procesin e përgatitjes së projektbuxhetit për vitin e ardhshëm dhe proritete për dy vitet në vijim, përkatësisht për vitin 2020 dhe prioritetet për 201/2022. Afati i miratimit të projektbuxhetit është më së largu fundi i muajit shtator. Buxheti fillestar është përcaktuar mbi bazën e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2020/01 dhe Qarkores Buxhetore 2020/01 të Ministrisë së Financave si dhe projeksonet fillestare të projekteve kapitale, që do të përfshihen në projektbuxhetin e Komunës, prandaj me qëllim të transparencës dhe që qytetarët të jenë pjesë e përgatitjes së projektbuxhetit përkatësisht pjesë e vendimmarrjes, organizohen edhe takime të tilla në lokalitete dhe pjesë të ndryshme të Komunës së Podujevës me qëllim që qytetarët të paraqesin nevojat dhe prioritetet e investimeve në secilin lokalitet, të cilat pastaj analizohen dhe vlerësohen dhe varësisht mundësive buxhetore mund të përfshihen në planifikimet buxhetore të Komunës, kjo ngase për propozime, kërkesa, duhet të ketë një arsyeshmëri për shkak që secili projekt duhet t'i përmbush disa kriteret për të qenë i përfshirë në planifikime buxhetore.

Prezent këtu janë edhe disa prej Drejtorëve të Drejtorive si dhe zyrtari përkatës i cili mban procesverbal, të cilët natyrisht që marrin shënime dhe eventualisht mund të japim sqarime dhe përgjigje të ndryshme në raste se paraqitet nevoja si dhe do të evidentojmë kërkesat e juaja dhe varësisht natyrës së tyre do t'ju përcjellim Drejtorive përkatëse, andaj pa humbur kohë, fjala është për Ju të nderuar pjesëmarrës dhe kërkoj që të kontribuoni me propozime dhe kërkesa për investime në projekte konkrete.

Kadri Tërhooli, nga fshati Sfeçël, paraqiti kërkesën për renovimin e objektit të shkollës së vjetër si dhe vendosjen e rrethojave të saj.

Rrahman Bjetullahu, nga fshati Sfeçël, u pajtua me parafolësin për renovimin e objektit të shkollës së vjetër të fshatit si dhe paraqiti kërkesën që objekti në fjalë të konzervohet ose të destinohet për bibliotek. Gjithashtu paraqiti kërkesën për asfaltimin e rrugës kryesore që lidhet nga hekurudha në Sfeçël deri te vendi i ashtuquajtur “polonica”.

Ismajl Visoka, nga fshati Sfeçël, paraqiti kërkesën për asfaltimin e rrugës rreth 200 m, në lagjen Mehana dhe Bradashi.

Avdi Paçarada, nga fshati, paraqiti kërkesë për asfaltimin e rrugës në gjatësi rreth 100 m, në lagjen ku ai jeton.

Hetem Ajeti, nga fshati Sfeçël, kërkoj të definohet pronësia ku është e vendosur lapidari i Heronjve që gjendet në afërsi të ambulantes në fshatin Sfeçël.

Hamdi Jaha, drejtor i DPUMM, fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoj për pjesëmarrje në këtë takim, ndër të tjera theksoi, nëse marrim për bazë fshatrat tjera të Komunës së Podujevës, në fshatin Sfeçël, viteve të fundit janë bërë mjaftë investime të ndryshme, por ende mbeten edhe disa projekte infrastrukturore e që shpresojmë se do të kryehn edhe ato në vitet në vijim.

Rrahman Bjetullahu, nga fshati Sfeçël, nuk pajtohem me drejtorin e DPUMM i cili tha se në fshatin Sfeçël janë bërë investime sepse në fshat nuk ka ndriçim publik, nuk trotuare, me përjashtim të një pjese në afërsi të shkollës, dhe gjëra tjera në fusha të ndryshme.

Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSSH, përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoj për pjesëmarrje në këtë takim, theksoi, dëgjova disa kërkesa dhe mospajtime që u shprehen deri tani gjatë takimit, dëshiroj t'uj njoftoj se disa prej tyre janë në procedurë dhe do të kryhen gjatë vitit 2019.

Bekim Vërshevci, nga fshati Sfeçël, paraqiti kërkesën për shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik në brendësi të fshatit Sfeçël.

Abaz Llugaliu, në cilësinë e përfaqësuesit të fshatit Surkish, paraqiti kërkesën për përgatitjen e një projekti për 10 puset e ashtuquajtura "Pusat e Surkishit".

Fahredin Topanica, nga fshati Sfeçël, paraqiti kërkesën për zgjerimin e urës në rrugën e lagjes Vërshevc në fshatin Sfeçël.

Flamur Jaha, nga fshati Sfeçël, paraqiti kërkesat;

- Ndërtimin e një fushe sportive për banorët e fshatit,
- Shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik në rrugët kryesore të fshatit,
- Rritjen e subvencioneve për bujqësi,
- Rregullimin e trotuarit në rrugën e ashtuquajtur "Lagja e poshtme"

Bajram Avdullahu, nga fshati Sfeçël, paraqiti kërkesat;

- Mbjelljen e drunjve dekorativ në hapësirat e shkollës së fshatit,
- Rregullimin e ngrohjes së shkollës,
- Vendosjen e dy pengesave (policëve të shtrirë) në afërsi të shkollës,
- Rregullimin e një parku në afërsi të Zyrës së Gjendjes Civile

Isuf Merovci, nga fshati Sfeçël, gjithashtu kërkoj vendosjen e pengesave (policëve të shtrirë) në rrugën nga varrezat e fshatit deri në dalje të fshatit

Vehbi Podvorica, përfaqësues i fshatit Dumosh, paraqiti kërkesat;

- Asfaltimin e rrugës rreth 1 km, nga lagja Vokkri deri në hyrje të fshatit Siboc i Epërm
- Asfaltimi i rrugës që ligj lagjen Paçarada me fshatit Siboc i Epërm,
- Rregullimi me zhavorr i parkut në brendësi të fshatit përkatësisht përballë shkollës së fshatit.

Isuf latifi, drejtor i DBF, i falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje në takim. Theksoi, ne i evidentuam të gjitha kërkesat e juaja dhe për disa veç u dhanë sqarime, natyrisht që të gjitha do t'i analizojmë dhe do t'i vlerësojmë me qëllim të përfshirjes së tyre në planifikimet trevjeçare buxhetore të Komunës, andaj me kaq e konstatoi të mbyllura këtë takim.

Takimi përfundoi në orën 15:25

Procesverbalin e mbajti:

Latif Mehmeti

Nr.prot.04-400/01-0065577/19

**Podujevë,
08 gusht 2019**

**Drejtori i DBF
Isuf Latifi**